



**SHOQËRIA “REZIDENCA  
STUDENTORE UNIVERSITARE  
NR. 1” sha**

Nr. 789 prot.,  
Tiranë, më 01.042026



**MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MIRËQENIES SOCIALE  
SHËRBIMI SOCIAL  
SHTETËROR**

Nr. 2991 prot.,  
Tiranë, më 01.042026

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI  
NDËRMJET**

**SHOQËRISË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SH.A  
DHE  
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR**

**“PËR**

**PËRFSHIRJEN E STUDENTËVE NË PRAKTIKA MËSIMORE  
PRANË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR DHE INSTITUCIONEVE TË  
VARËSISË”**

Lidhur sot, më datë 01.04 2026, ndërmjet:

**SHOQËRISË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA**, me adresë  
Rruga “Arben Broci”, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Z.Olsi Shahini, në cilësinë e Drejtorit  
të Përgjithshëm (këtu e në vijim referuar si “RSU. 1”).

dhe

**SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR**, me adresë “Rruga e Durrësit, Nr. 83 Tiranë”  
Tiranë, përfaqësuar nga Znj. Reme Xholi, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm (këtu e në vijim  
referuar si “SHSSH”)

Të cilët së bashku do të quhen “*Palët*” dhe individualisht “*Pala*”.

**DEKLARIME PARAPRAKE:**

- A. Shoqëria “Rezidenca Studentore Universitare nr.1, sh.a, ka si objekt veprimtarie trajtimin në fjetore të studentëve të Universiteteve të Tiranës;
- B. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e ushtrimit të profesionit të punonjësve të shërbimit social me zotësi, me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor.
- C. Zhvillimin e takimeve të hapura me studentët nga Shërbimi Social Shtetëror për të arritur zhvillimin profesional dhe social të tyre në Qytet Studenti;

D. Që prej nisjes së bashkëpunimit mes dy institucioneve shprehur në këtë marrëveshje, krijohet mundësi praktike të studentëve në strukturat e SHSSH dhe institucioneve në varësi, në përputhje me fushën e tyre të studimit;

Palët duke shprehur vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë, deklaruan se bien dakord të nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi, në zbatim të kërkesave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

Palët bien dakort si më poshtë vijon.

## **NENI 1**

### **BAZA LIGJORE**

Kjo marrëveshje bazohet në Ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, i ndryshuar; Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; VKM nr. 135/2018, “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror” i ndryshuar; Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## **NENI 2**

### **OBJEKTI I MARRËVESHJES**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e një bashkëpunimi të ndërsjelltë për përfshirjen në praktika mësimore të studentëve të akomoduar pranë RSU Nr.1, sh.a pranë Shërbimit Social Shtetëror dhe strukturave të varësisë, veçanërisht të studentëve që ndjekin programet studimore që përfshihen në fushën e shërbimeve sociale në spektrin gjithëpërfshirës të saj sa i përket programeve specifike të studimit.

## **NENI 3**

### **ROLET DHE DETYRIMET E PALËVE**

3.1 Shoqëria “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1” sha angazhohet të:

- Identifikojë studentët e përshtatshëm për zhvillimin e praktikave profesionale në institucionet në varësi të SHSSH-së, në përputhje me fushën e tyre të studimit;
- Koordinojë procesin e zhvillimit të praktikave të studentëve me strukturat përkatëse të SHSSH-së;
- Përcaktojë një person përgjegjës për koordinimin e praktikave të studentëve me SHSSH;
- Sigurojë komunikim të vazhdueshëm ndërinstitucional, me qëllim lehtësimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit;
- Sigurojë ambientet për zhvillimin e takimeve të hapura me studentët për çështje të lidhura me fushën e kompetencës së SHSSH.

3.2 Shërbimi Social Shtetëror merr përsipër të:

- Menaxhojë numrin e sistemimeve në praktika në strukturat e SHSSH dhe institucioneve në varësi, në përputhje me fushën e studimit dhe fluksin e punës;
- Sigurojë një person përgjegjës (supervisor) për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e praktikës së studentëve;
- Organizojë takime të hapura me specialistë të SHSSH-së mbi tema të lidhura me fushën e kompetencës së SHSSH, për të cilat studentët kanë interes;
- Të lëshojë vërtetim për kryerjen e praktikës mësimore.

**NENI 4**  
**KOHËZGJATJA E MARRËVESHJËS**

- 4.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe ka një afat 1 (një) vjeçar, me mundësi rinovimi midis palëve.
- 4.2 Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje duke njoftuar më shkrim 1 (një) muaj përpara palën tjetër.

**NENI 5**  
**KOMUNIKIMI**

5.1 Kur njëra nga Palët detyrohet ose është e legjitimuar të njoftojë ose drejtojë tek pala tjetër, ose të paraqesë një kërkesë, këto të fundit duhet të paraqiten në formë të shkruar dhe do të konsiderohen se janë dorëzuar nëse dërgohen dorazi tek personi tek i cili janë drejtuar ose nëse dërgohen nëpërmjet rrugës elektronike (e-mail) tek pala së cilës i referohen në adresën e mëposhtme ose atë të ndryshuar përkatësisht, duke marrë të mirëqenë se një ndryshim i tillë i është njoftuar palës tjetër në mënyrat e përcaktuara në këtë nen. Komunikimet do të adresohen si më poshtë:

*SHOQËRIA "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1" sha*

Adresa: Rruga "Arben Broci", Tiranë

Në vëmendje të: Znj. Anxhela Peza

Tel: 0672058116

Email: ap.peza@gmail.com

*SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR*

Adresa: Rruga "Rruga e Durrësit, Nr. 83 Tiranë, Tiranë

Në vëmendje të: Znj. Xhulia Musta

Tel: 0684449027

Email: Xhulia.Musta@sherbimisocial.gov.al

Personat e caktuar do të jenë përgjegjës për zbatimin e kësaj Marrëveshje.

5.2 Për çdo ndryshim në adresat e përcaktuara më sipër Palët kanë detyrim të njoftojnë verbalisht menjëherë dhe me e-mail brenda 48 orësh, për këto ndryshime. Në rast të kundërt, njoftimi do të konsiderohet si i kryer në momentin e dërgimit në adresat e përcaktuara sipas kontratës.

**NENI 6**  
**DISPOZITA E FUNDIT**

6.1 Marrëveshja zëvendëson çdo lloj korrespondence të mëparshme të mbajtur midis palëve. Kjo Marrëveshje mbizotëron mbi çdo term ose detyrim tjetër ose dokument tjetër që është pranuar nga palët kontraktuese.

6.2 Kontrata jo formale janë të vlefshme vetëm nëse materializohen në formë të shkruar. Ky rregull duhet të ndiqet edhe në rastin e ndryshimeve ose modifikimeve pasuese të cilat nuk janë miratuar nga përfaqësuesit ligjorë ose nga persona të legjitimuar të përfaqësojnë palën përkatëse kontraktuese.

6.3 Mosekzekutimi i ndonjë të drejte të njohur nga Marrëveshja nuk do të konsiderohet si heqje dore nga kjo e fundit.



6.4 Në rast se ndonjë nga dispozitat e Marrëveshjes ose pjesë e saj është ose shpallet e pavlefshme, nuk do të çënohet vlefshmëria e dispozitave të tjera.

6.5 Anekset që mund të shtohen në vijim të bashkëpunimit i bashkëngjiten Marrëveshjes si pjesë integrale të saj.

#### NENI 7

### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

7.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje fillimisht Palët do ta zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërt do t'i drejtohen gjykatës kompetente.

7.2 Termat dhe kushtet e përcaktuara këtu përbëjnë marrëveshjen e plotë midis palëve dhe mund të ndryshohen ose shtohen vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga Palët e kësaj Marrëveshje.

7.3 Kjo marrëveshje mund të ndërpritet nga secila palë me njoftim të paktën 30 ditë përpara.

#### NENI 8

### HYRJA NË FUQI

Kjo marrëveshje hyn në fuqi më datë 01.04. dhe përpilohet në katër kopje, në gjuhën shqipe, me vlefshmëri të njëjtë secila, nga dy kopje për secilën Palë.

Palët firmosin si më poshtë:

**PËR  
SHOQËRINË "RSU NR.1"**

**Z. OLSI SHAHINI  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**



**PËR  
SHËRBIMIN SOCIAL  
SHTETËROR**

**ZNJ. REME XHOLI  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

